



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

Për:	Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës së Prishtinës Agim Kuleta, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prishtinës	
Cc:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së	
Nga:	Shkelqim Jakupi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 18/06/2018 Nr.020-671
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Prishtinës	
Lloji i aktit:	Rregullore e Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal në vijim:

Rregullore Nr.01-030/01-0134831/18 për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës
Të miratuar më datë: 31/05/2018
Të parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 08/06/2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së akteve të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës, **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tilla mund të prodhojë efekte juridike.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës


Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration



Za:	Shpend Ahmeti, gradonačelnik Opštine Priština Agim Kuleta, predsedavajući Skupštine opštine Priština	
Cc:	Jednici za administraciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko:	Ivan Todosijević, ministar MALS-a Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a	
Od:	Shkëlqim Jakupi, rukovodilac Odeljenja za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS	Datum: 18.06.2018. Br. 020-671
Predmet:	Potvrda zakonitosti akta opštine Priština	
Vrsta akta:	Odluka Skupštine opštine	

Poštovani gradonačelnice,
Poštovani predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je zahtev za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđen članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Pravilnik br.01-030/01-0134831/18 za organizovanje i saradnju opštine sa selima, nasekjenim mestima i urbanim naseljima na teritoriji opštine Priština.

Usvojena dana, 31.05.2018. godine,

Predložena na razmatranje u MALS-u dana, 08.06.2018. godine,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akti u saglasnosti sa zakonskim odrebama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni učinak.

Ministarsvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

MINISTRI I ADMINISTRATËS LOKALE
MINISTRI I QARKUT I PRISHTINËS
MINISTRI I QARKUT I PRISHTINËS
Ministria e Administratës Lokale dhe Samëgjendjes
Ministry of Local Government Administration
Tema _____
Data: 02.06.2016
Dokumenti: _____

RREGULLORE

PËR ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRA, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PRISHTINËS

Poseduesi i dokumentit:	Per Sektorin:	Pergatitur me	Miratuar nga
Drejtoria e Administratës	Sektori i bashkësive lokale	17.11.2016	Drejtori i Administratës
		Ndryshuar me	

PËRMBAJTJA

PROPOZIM RREGULLORE.....	3
ANNEX 1 - Harta e bashkësive lokale të Komunës së Prishtinës pa emërtime të rrugëve.....	11
ANNEX 2-TERRITORI QË I PËRKET SECILËS BASHKËSI LOKALE	12
ANNEX 3- EMËRTIMET E RRUGËVE TË SECILËS BASHKËSIE LOKALE	17
BASHKËSITË LOKALE URBANE	17
BASHKËSITË LOKALE RURALE	18
EMËRTIMET E RRUGËVE	19

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja c), nenit 34, paragrafi 34.4 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008"), Udhëzimit administrativ të MAPL, nr. 2008/08, për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja d të Statutit të Komunës 01 nr. 110-391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 31.05.2018, miratoi këtë

R R E G U L L O R E

P Ë R

ORGANIZIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRA T, V E N D B A N I M E T D H E L A G J E T U R B A N E N Ë T E R R I T O R I N E K O M U N Ë S S Ë P R I S H T I N Ë S

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të rregullojë organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e komunës, në ushtrimin e aktiviteteve që janë ekskluzivisht në kompetencë vetanake të komunave, të përcaktuara në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale.

Neni 2

Fushëveprimi

Kjo rregullore rregullon mënyrën e organizimit dhe bashkëpunimit midis Komunës, fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, duke formuar këshillat lokalë, si trupa mbështetës të organeve të Komunës, dhe që ndikojnë në konsultime gjithëpërfshirëse, të cilat promovojnë dhe zhvillojnë transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes.

Neni 3

Formimi i këshillave lokalë

- 3.1. Për të realizuar sa më mirë funksionet dhe përgjegjësitë e parapara me Ligjin për vetëqeverisje lokale, Komuna e Prishtinës do të mbështesë zgjedhjen e këshillave lokalë të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane dhe kryetarët e këshillave lokalë. Një këshill lokal mund të përfshijë një e më tepër fshatra, vendbanime apo lagje urbane.

- 3.2. Numri i këshillave lokalë të fshatrave, vendbanimeve formale dhe joformale dhe lagjeve urbane, do të themelohen në nivel të këshillave lokalë dhe do të paraqiten në listë të veçantë, shtojca nr. 1, që do të jetë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 4

Formimi i komisionit nga Kuvendi i Komunës për zgjedhjen e këshillave lokalë

- 4.1. Kuvendi i Komunës emëron një komision për të udhëhequr dhe koordinuar punën në teren në zgjedhjen e këshillave lokale. Komisioni duhet të ketë 7 anëtarë: 5 (pesë) anëtarë nga Kuvendi i Komunës, 1 (një) nga shoqëria civile dhe 1 (një) nga përfaqësuesit e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane. Nga 7 anëtarët e Komisionit 3 (tre) duhet të jenë femra, si dhe 1 anëtar ose anëtare pajetër të jetë e Komunitetit jo shumicë. Përbërja e komisionit duhet të përfaqësojë përbërjen e subjekteve politike me numër më të madh të anëtarëve të përfaqësuar në Kuvendin e Komunës. Kryesuesi i komisionit zgjidhet nga anëtarët e komisionit.
- 4.2. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës, duhet të jetë përgjegjës për caktimin e periudhës kohore të mbajtjes së tubimeve me qytetarë, për zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokalë dhe kryetarëve të këshillave lokalë të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.
- 4.3. Së paku tre 3 anëtarë të komisionit të Komunës duhet të jenë të pranishëm në të gjitha tubimet zgjedhore që organizohen për zgjedhjen e këshillave lokalë.
- 4.4. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës dhe përfaqësuesit e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, bashkëpunojnë në mënyrë që të organizojnë zgjedhjen e anëtarëve të këshillave lokalë dhe kryetarëve të këshillave lokalë.
- 4.5. Të gjithë qytetarët pjesëmarrës në tubimin zgjedhore, mund të paraqesin ankesat e tyre, nëse konstatojnë ndonjë parregullsi gjatë procesit zgjedhor. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës, është i obliguar që t'i shqyrtojë të gjitha ankesat dhe, brenda afatit prej 15 ditëve nga data e parashtrimit të kërkesës, t'u kthejë përgjigje me shkrim atyre që kanë adresuar ankesa.
- 4.6. Komisioni i emëruar nga Kuvendi i Komunës, përmes Zyrës për informim, informon qytetarët 15 ditë para datës së mbajtjes së tubimit të qytetarëve për zgjedhjen e këshillave lokalë, përmes:
- 4.6.1 shpalljeve publike, të vendosura në objektet publike dhe vendet më të frekuentuara brenda territorit ku mbahen tubimet për zgjedhjen e këshillave lokalë;
 - 4.6.2 medieje lokale;
 - 4.6.3 ueb-faqes zyrtare të Komunës.
- 4.7. Njoftimi për publikun duhet të përmbajë:
- 4.7.1 rendin e ditës,

- 4.7.2 datën,
4.7.3 kohën dhe
4.7.4 vendin e mbajtjes së tubimit.
- 4.8. Pas përfundimit të procesit zgjedhor të këshillave lokalë dhe kryetarëve të këshillave lokalë, komisioni i formuar nga Kuvendi i Komunës pushon aktivitetin.

Neni 5

Formimi i këshillave lokalë dhe kriteret e përzgjedhjes

- 5.1. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane mund të ketë nga 5 deri në 9 anëtarë. Numri i saktë i anëtarëve për secilin këshill lokal përcaktohet nga vet banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që janë të pranishëm në tubimin zgjedhor.
- 5.2. Cdo fshat, lagje urbane duhet të jetë i përfaqësuar në këshillin lokal. Në rast kur këshilli lokal ka numër qift të fshatrave, vendbanimeve, lagjeve urbane, atëherë vendbanimi, fshati, lagja urbane me numër më të madh të banorëve jep dy anëtarë në këshillin lokal.
- 5.3. Përbërja e këshillave lokalë duhet të reflektojë përbërjen etnike dhe gjinore. Përfaqësimi gjinor duhet të përfshijë minimum 30% të gjinisë femërore, sipas Ligjit për barazinë gjinore. Në rast se në fshat, vendbanim apo lagje urbane jetojnë pjesëtarë të komuniteteve jo shumicë, duhet të jenë të përfaqësuar në këshillin lokal nëse janë të pranishëm në tubim. Nëse kemi më shumë se një komunitet të pakicës, komuniteti që ka shumicën duhet të përfaqësohet në këshill lokal.
- 5.4. Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të Komunës zgjedhin anëtarët e këshillit lokal me rastin e tubimit të qytetarëve, që mbledh të gjithë banorët e interesuar të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane.
- 5.5. Zgjedhja bëhet përmes votimit të fshehtë në tubimin e qytetarëve.
- 5.6. Kandidatët për anëtarë të këshillave lokalë duhet të jenë banorë të përhershëm në atë lokalitet.
- 5.7. Kandidatët për pozita të anëtarëve dhe të kryetarëve të këshillave lokalë, nuk mund të kandidohen nëse janë të zgjedhur në poste politike.
- 5.8. Anëtarë të këshillave lokalë të fshatrave, vendbanimeve apo lagjeve urbane, zgjidhen kandidatët të cilët fitojnë numrin më të madh të votave nga numri i përgjithshëm i banorëve të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane që janë të pranishëm në tubimin zgjedhor.
- 5.9. Kryetari i këshillit lokal zgjidhet nga radhët e anëtarëve të këshillit lokal të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, kandidati i cili fiton shumicën e votave të qytetarëve që marrin pjesë në atë tubim.
- 5.10. Nëse në rrethin e parë të votimit kemi dy apo më shumë kandidatë me numër të barabartë të votave, atëherë organizohet rrethi dytë i votimit dhe kandidati që merr më shumë vota zgjidhet për anëtarë, kryetar i këshillit lokal.

- 5.11. Të drejtë vote kanë të gjithë banorët me moshë mbi 18 vjeç të atij lokaliteti. Numri i kandidatëve të propozuar për këshill lokal duhet të jetë më i lartë se numri i përcaktuar për t'u zgjedhur.
- 5.12. Anëtarët dhe kryetarët e këshillave lokale të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, zgjidhën me mandat 3-vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat.
- 5.13. Tubimet e kanë legjitimitetin juridik, nëse në tubime janë të pranishëm së paku 50 pjesëmarrës me të drejtë vote të atij lokaliteti, që duhet të përfshijë së paku 30% të gjinisë femërore.

Neni 6

Ndërprerja dhe pushimi i mandatit të anëtarëve dhe kryetarëve të këshillave lokale

- 6.1. Në rastet kur qytetarët konsiderojnë se anëtarët ose kryetari i këshillit lokal nuk i kanë përmbushur obligimet që dalin nga kjo rregullore, anëtarët dhe kryetari i këshillit lokal mund të shkarkohen me shumicë të votave të banorëve të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane me rastin e tubimit publik me qytetarë.
- 6.2. Në mënyrë që të bëhet ky votim, kërkohet një peticion për ndërprerjen e mandatit që duhet të nënshkruhet nga banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane. Ky peticion duhet të mbledh nënshkrimet e më shumë se gjysma e numrit të pjesëmarrësve nga takimi ku është zgjedhur këshilli lokal. Peticioni i dorëzohet Drejtorisë së Administratës dhe Sektorit për punë në Kuvend, të cilët pastaj e procedojnë tek anëtarët e Komisioni të formuar tek Neni 4 pika 1, të cilët anëtarë duhet të lajmërohen paraprakisht për një mbledhje të tillë.
- 6.3. Në rastet kur këshilli lokal shkarkohet sipas procedurave të parapara në paragrafin 2, një votim i ri duhet të bëhet menjëherë, në bazë të procedurave të nenit 5 të kësaj rregulloreje, në mënyrë që të zgjidhet një këshill i ri lokal. Rezultatet e votimit duhet të raportohen në bazë të kërkesave të nenit 6 të kësaj rregulloreje.
- 6.4. Mandati i kryetarëve dhe anëtarëve të këshillave lokale përfundon:
 - 6.4.1. me kryerje të mandatit,
 - 6.4.2. nëse vdes,
 - 6.4.3. nëse jep dorëheqje,
 - 6.4.4. nëse ndërron vendbanim,
 - 6.4.5. nëse shkarkohet,
 - 6.4.6. nëse kryen vepër penale.

Neni 7 Procesverbali nga tubimi zgjedhor

- 7.1. Procesverbali i hartuar nga tubimi i qytetarëve, duhet të përmbajë datën, orën dhe vendin e mbajtjes së tubimit, numrin e qytetarëve që kanë marrë pjesë në tubim, listën e pjesëmarrësve, të dhënat për zgjedhjen e anëtarëve dhe kryetarëve të këshillave lokalë, procedurat e votimit dhe çështje të tjera të adresuara në takim.
- 7.2. Procesverbalin e nënshkruainë kryesuesi i tubimit, anëtarët e komisionit dhe procesmbajtësi, ndërsa komisioni i përcaktuar sipas nenit 4 të kësaj rregulloreje, i raporton Kuvendit të Komunës për rrjedhën e tubimeve dhe për zgjedhjen e këshillave lokalë të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane.
- 7.3. Rezultatet e zgjedhjeve, emrat e anëtarëve dhe të kryetarit të këshillit lokal, duhet të bëhen publike menjëherë pas tubimit zgjedhor.

Neni 8 Konsultimet ndërmjet Komunës dhe këshillave lokalë

- 8.1. Kryesuesi i Kuvendit dhe Kryetari i Komunës, ftojnë përfaqësuesit e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane që të marrin pjesë në tubimet publike me qytetarë, në dëgjimet publike për buxhet, tubimet e rregullta publike, takimet për planifikim të politikave zhvillimore komunale që organizohen nga organet komunale.
- 8.2. Së paku një anëtar i këshillit lokal të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, duhet të jetë i përfshirë në të gjitha grupet punuese komunale për planifikim të planeve urbane, zhvillimore dhe rurale që janë pjesë e lokalitetit ku ata jetojnë.
- 8.3. Kryetari i Komunës duhet të organizojë së paku dy takime në vit me udhëheqësit e këshillave lokalë. Takimet duhet të mbahen së paku një herë në gjashtë muaj. Për rendin e ditës duhet të konsultohen edhe udhëheqësit e këshillave lokalë.
- 8.4. Kuvendi i Komunës mund të kërkojë një opinion nga këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, në çështje të caktuara me interes për komunitetin.

Neni 9 Bartja e aktiviteteve nga komuna te këshillat lokalë

- 9.1. Me kërkesën e këshillit lokal dhe rekomandimin e Kryetarit të Komunës, apo ndonjë komiteti të Komunës, Kuvendi i Komunës me vendim, mund të bartë disa përgjegjësi për t'i ushtruar këshillat lokalë të fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane. Aktivitetet që mund të

transferohen, duhet të jenë në kompetencë ekskluzive vetanake të Komunës.

- 9.2. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane, duhet të konsultohet dhe pranojë bartjen e aktiviteteve nga Komuna në këshillin lokal.
- 9.3. Në rast të bartjes së aktiviteteve nga komuna në këshillin lokal, komuna do të angazhohet të ofrojë mbështetje dhe burime të mjaftueshme për Zyrat lokale/këshillat e fshatrave, vendbanimet dhe lagjet urbane me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisë së bartura.

Neni 10

Roli, detyrat dhe përgjegjësitë e këshillave lokalë

- 10.1. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, mund të takohet në çdo kohë për të shqyrtuar çështjet në interes të lokalitetit, si dhe harton dhe miraton planin e punës së këshillit dhe rregullat e brendshme të funksionimit.
- 10.2. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, organizon, përcjell dhe planifikon planet dhe programet zhvillimore të lokalitetit në të gjitha sferat, në bashkëpunim me Kuvendin e Komunës, Kryetarin e Komunës, komitetet dhe drejtoritë komunale.
- 10.3. Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, duhet të informojë Komunën për kohën dhe agjendën e takimeve. Zyrtarët komunalë mund të marrin pjesë në takimet e organizuara nga këshillat lokalë.
- 10.4. Këshillat lokalë mund të formojnë nënkëshillat lokalë, bazuar në ndarjen e zonave dhe numrin e lokaliteteve të specifikuar në listën shtojcë, që është pjesë e kësaj rregulloreje.
- 10.5. Takimet e qytetarëve mund të organizohen me iniciativën e këshillit lokal të fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane.
- 10.6. Këshilli lokal mund të ndër marrë aktivitetet, të cilat në vecanti ndikojnë në:
 - 10.6.1. zhvillimin lokal ekonomik të qëndrueshëm të lokalitetit;
 - 10.6.2. planifikimin urban dhe rural të lokalitetit;
 - 10.6.3. mbrojtjen e mjedisit lokal të lokalitetit;
 - 10.6.4. rritjen e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve publike komunale brenda lokalitetit;
 - 10.6.5. sigurimin e të dhënave elementare për çdo familje të lokalitetit përkatës, përcjell gjendjen e tyre ekonomike, sociale dhe jep rekomandime, propozime për mbështetje të këtyre rasteve;
 - 10.6.6. mirëmbajtjen e varrezave dhe hapësirave publike të gjelbëruara;
 - 10.6.7. zhvillimin e turizmit;
 - 10.6.8. organizimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive;
 - 10.6.9. bashkëpunimin me organet e Komunës dhe organizata të tjera të shoqërisë civile për çështjet me interes për lokalitetin;
 - 10.6.10. organizimin e aksioneve vullnetare në interes për lokalitetin.

- 10.6.11.zbatimin e aktivitetet që janë të bartura, sipas procedurave të nenit 8 të kësaj rregulloreje.
- 10.7. Me vendim të Kryetarit të Komunës, një anëtar i këshillit lokal mund të jetë pjesë e organeve mbikëqyrës për monitorimin, zbatimin e projekteve për investimeve kapitale në lokalitetet e tyre.
- 10.8. Këshillat lokalë të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, kanë të drejtë të bashkëpunojnë në mes veti në territorin e komunës përkatëse.
- 10.9. Këshillat lokalë kanë të drejtë t'u parashtrojnë kërkesë me shkrim organeve të Komunës për çështje të ndryshme në interes të lokalitetit, kurse organet e Komunës brenda afatit 30 ditësh, i përgjigjen me shkrim këshillit lokal.

Neni 11

Roli i kryetarëve të këshillave lokalë

- 11.1. Kryetari i këshillit lokal përfaqëson fshatin, vendbanimin apo lagjen urbane në konsultimet dhe diskutimet me organet e Komunës. Kryetari i Këshillit lokal ka obligim t'i informoj anëtarët e Këshillit për rezultatet ose konkluzionet nga takimet e përshkruara në paragrafin paraprak.
- 11.2. Kryetari i këshillit lokal thërret dhe udhëheq me mbledhjet e këshillit lokal dhe kujdeset për organizimin dhe punën e këshillit lokal. Po ashtu, ai i nënshkruan konkluzionet dhe propozimet e miratuara nga ana e këshillit lokal dhe është i obliguar që në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të tyre, t'i dorëzojë te Kryetari i Komunës.

Neni 12

Financimi i aktiviteteve

- 12.1. Financimi i aktiviteteve të këshillave lokalë mund të bëhet nga vetë banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane, nga Komuna, nga financimi i përbashkët, si dhe nga donatorët, në pajtueshmëri të plotë me Statutin, rregulloret komunale dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Kosovës për menaxhim të financave publike.
- 12.2. Këshilli lokal përgatit raporte gjashtëmujore dhe vjetore të mjeteve të arkëtuara dhe mjeteve të shpenzuara, dhe i bën ato transparente për qytetarët e atij lokaliteti dhe organet komunale.
- 12.3. Këshillat lokalë janë të obliguar që të gjitha aktivitete e tyre financiare, t'i zhvillojnë përmes llogarisë bankare në emër të këshillit lokal.

Neni 13

Kompensimi i këshillave lokalë

Kompensimi i kryetarëve të këshillave lokalë të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, përcaktohet nga Kuvendi i Komunës me vendim të veçantë.

Neni 14

Mos përmbushja e përgjegjësisë

Këshilli lokal i fshatit, vendbanimit dhe lagjes urbane përkatëse, mban obligime dhe përgjegjësi ligjore për të gjitha aktivitetet e bartura nga Kuvendi i Komunës në këshillin lokal.

Neni 15

Dispozitat kalimtare, shfuqizuese dhe përfundimtare

15.1. Në rast konflikti të dispozitave të kësaj rregulloreje me Ligjin për vetëqeverisje lokale dhe Statutin e Komunës, mbizotërojnë dispozitat e Ligjit dhe Statutit.

15.2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat, vendbanimet, dhe lagjet urbane në territorin e komunës së Prishtinës, 01 nr. 110-1201, dt. 16.06.2010.

Neni 16

Ndryshimet

Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në këtë rregullore do të bëhen sipas procedurës së njëjtë të aprovimit të kësaj rregulloreje.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01-050/01-0134831/18, më 06.06.2018




KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



PRAVILNIK

O ORGANIZACIJI I SARADNJI OPŠTINE SA SELIMA, NASELJENIM MESTIMA, URBANIM KVARTOVIMA NA TERITORIJI OPŠTINE PRIŠTINA

Nosilac dokumenta	Za odsek:	Pripremljeno dana	Usvojen od strane:
Direkcija administracije	Odsek Mesnih Zajednica	17.11.2016	Direktora Administracije
		Izmenjeno:	

SADRŽAJ

PRAVILNIK.....	Error! Bookmark not defined.
ANNEX 1 - Mapa mesnih zajednica opštine Priština bez naziva ulica.....	11
ANNEX 2- TERITORIJE KOJE SU UKLJUČUJU U BILO KOJOJ MESNOJ ZAJEDNICI.....	12
ANNEX 3- NAZIVI ULICA KOJA SE ODOSE NA SVE MESNE ZAJEDNICE.....	17
URBANE MESNE ZAJEDNICE.....	17
RURALNE MESNE ZAJEDNICE.....	18
NAZIV ULICA.....	19

Na osnovu člana 12, stav 12.2, slovo c), član 34, stav 34.4 Zakona br. 03 / L-040 o Lokalnoj samoupravi, (Službeni list Republike Kosova, br. 28/2008), Administrativnog uputstvo MI SU br. 2008/08, o organizaciji i saradnji opštine sa selima, naseljenim mestima i urbanim kvartovima, i člana 34, stav 34.1, slovo d) Statuta opštine 01 br. 110-391 i dt. 25.2.2010 god., Skupština opštine, na sastanku održanom dana 31.05.2018, usvojila je

PRAVILNIK

O ORGANIZACIJI I SARADNJI OPŠTINE SA SELIMA, NASELJENIM MESTIMA, URBANIM KVARTOVIMA NA TERITORIJI OPŠTINE PRISTINA

Član 1 Cilj

Svrha ovog pravilnika je da regulise organizaciju i saradnju Opštine sa selima, naseljima i urbanim kvartovima na teritoriji opštine u vršenju delatnosti koje su isključivo u nadležnosti opštine utvrdene Zakonom o lokalnoj samoupravi.

Član 2 Delokrug

Ova uredba regulise način organizovanja i saradnje između opštine, sela, naselja i urbanih kvartova, formiranje lokalnih veća, kao pomoćna tela opštinskih organa, koji utiču na inkluzivnim konsultacijama, koje promovišu i razvijaju transparentnost, odgovornost i učesće građana u procesima donošenja odluka.

Član 3 Osnivanje mesnih zajednica

- 3.1. U cilju boljeg ostvarivanja funkcija i odgovornosti predviđenih Zakonom o lokalnoj samoupravi, Opština Pristina će podržati izbor lokalnih veća sela, naselja i urbanih kvartova i predsednika lokalnih veća. Jedan lokalni savet može uključiti jedno ili više sela, naselja ili urbana kvartova.
- 3.2. Broj lokalnih veća sela, formalnih i neformalnih naselja i urbanih kvartova biće usvojeni na nivou lokalnih veća i biće predstavljani na posebnoj listi, aneks br. 1, koji će biti sastavni deo ove uredbе.

Član 4 Formiranje komisije od strane Skupštine opštine za izbor lokalnih veća

- 4.1. Skupština opštine imenuje komisiju koja će voditi i koordinirati terenski rad u izboru lokalnih veća. Komisija treba imati 7 članova: 5 (pet) članova Skupštine opštine, 1 (jedan) iz civilnog društva i 1 (jedan) predstavnika sela, naselja ili urbanih kvartova. Od 7 članova Komisije 3 (tri) trebaju biti žene, a jedan član ili članica mora biti predstavnik nevećinske zajednice. Sastav komisije treba da predstavlja sastav političkih subjekata sa najvećim brojem članova predstavljenih u Skupštini opštine. Predsednika komisije biraju članovi komisije.
- 4.2. Komisija koja se imenuje od strane Skupština opštine, treba biti odgovorna za određivanje vremenskog perioda održavanja skupova građana, za izbor članova lokalnih saveta i predsednika lokalnih saveta sela, naselja i urbanih kvartova.
- 4.3. Najmanje troje članova Opštinske komisije trebaju biti prisutni na svim izbornim skupovima koji su organizuju za izbor lokalnih veća.
- 4.4. Komisija koja je imenovana od strane Skupštine opštine i predsednika sela, naselja i urbanih kvartova, saraduju kako bi organizovali izbor članova lokalnih veća i predsednika lokalnih veća.
- 4.5. Svi građani koji učestvuju na izbornom skupu, mogu podneti svoje žalbe ako u toku izbornog procesa uvide nepravilnosti. Komisija koju imenuje Skupština opštine dužna je da razmotri sve žalbe, u roku od 15 dana od dana podnošenja zahteva, i da pismeno odgovori onima koji su uputili žalbe.
- 4.6. Komisija koju je imenovana od strane Skupština opštine preko Kancelarije za obaveštavanje, obaveštava građane 15 dana prije prikupljanja građana za izbor lokalnih saveta, putem:
 - 4.6.1 javna izjavama, postavljena u javnim objektima i najčešće posećena mesta na teritoriji gde se održavaju skupovi za izbor lokalnih veća;
 - 4.6.2 lokalnim medijima;
 - 4.6.3 službenoj veb stranici opštine.
- 4.7. Obaveštenje za javnost treba da sadrži:
 - 4.7.1 dnevni red,
 - 4.7.2 datum,
 - 4.7.3 vreme i
 - 4.7.4 mesto održavanja skupova.
- 4.8. Nakon završetka izbornog procesa lokalnih veća i predsednika lokalnih veća, komisija koja je osnovana od Skupštine opštine prestaje sa radom.

Član 5

Formiranje lokalnih veća i kriterijumi za izbor

- 5.1. Lokalno veće sela, naselja ili urbanog naselja može imati između 5 i 9 članova. Tačan broj članova svakog lokalnog veća određuju stanovnici sela, naselja ili urbanog naselja koji su prisutni na izbornom skupu.
- 5.2. Svako selo, urbano naselje, treba da bude zastupljeno u lokalnom veću. U slučaju kada lokalni savet ima parni broj sela, naselja, urbanih kvartova,

- onda naselje, selo, urbano naselje sa najvećim brojem stanovnika daju dva člana lokalnom veću.
- 5.3. Sastav lokalnih veća treba da predstavlja etnički i rodni sastav. Zastupljenost polova treba da sadrži najmanje 30% ženskog pola, u skladu sa Zakonom o punoj ravnopravnosti. Ako u selima, naseljima ili urbanim naseljima žive članovi ne-većinskih zajednica, oni moraju biti zastupljeni u lokalnom veću ako su prisutni na skupu. Ako imamo više od jedne manjinske zajednice, zajednica koja ima većinu mora biti zastupljena u lokalnom veću.
 - 5.4. Opštinska sela, naselja i urbana naselja biraju članove lokalnog veća povodom sakupljanja građana, okupljajući sve zainteresovane stanovnike sela, naselja ili urbanog naselja.
 - 5.5. Izbori se vrše tajnim glasanjem lokom skupa građana.
 - 5.6. Kandidati za članove lokalnih veća trebaju biti stalni stanovnici u tom lokalitetu.
 - 5.7. Kandidati za položaj članova i predsednika lokalnih veća ne mogu kandidirati ako su izabrani na političkim pozicijama.
 - 5.8. Kao članovi lokalnih veća sela, naselja ili urbanih kvartova biraju se kandidati koji prime najveći broj glasova od ukupnog broja stanovnika sela, naselja ili urbanog naselja koji su prisutni na izbornom skupu.
 - 5.9. Predsednik lokalnog veća bira se od strane članova lokalnog veća sela, naselja ili urbanog naselja, kandidat koji dobije većinu glasova građana koji učestvuju na tom skupu.
 - 5.10. Ako u prvom krugu glasanja imamo dva ili više kandidata sa jednakim brojem glasova, onda se organizuje drugi krug glasanja i kandidat koji dobije najveći broj glasova bira se kao član, predsednik lokalnog veća.
 - 5.11. Pravo glasanja imaju svi stanovnici koji su starijih od 18 godina tog lokaliteta. Broj predloženih kandidata za lokalni savet bi trebao biti veći od broja koji se treba izabrati.
 - 5.12. Članovi i rukovodioci lokalnih veća sela, naselja ili urbanog naselja, biraju su trogodišnjim mandatom, uz mogućnost ponovnog izbora za još jedan mandat.
 - 5.13. Mitinzi imaju zakonski legitimitet, ukoliko na skupovima prisustvuje najmanje 50 članova koji imaju pravo glasanja i koji žive na tom lokalitetu, i treba uključiti najmanje 30% ženskog pola.

Član 6

Ukidanje i prestanak mandata članova i predsednika lokalnih veća

- 6.1. U slučajevima kada građani smatraju da članovi ili predsednik opštinskog veća nisu ispunili obaveze koje proizlaze iz ovog pravilnika, članovi i predsednik opštinskog veća mogu se ukloniti većinom glasova stanovnika sela, naselja ili urbanog naselja povodom javnog okupljanja sa građanima.

- 6.2. Da bi se izvršilo ovo glasanje, neophodna je peticija za prestanak mandata koji će potpisati stanovnici sela, naselja ili urbanog naselja. Ova peticija bi trebala da prikupi potpise više od polovine broja učesnika na sastanku na kojem se bira lokalni savet. Zahtev se podnosi Direkciji za Administraciju i Sektoru za rad Skupštine, koji zatim prosleđuju kod članova Komisije formirane u članu 4 tačka 1, i isti članovi moraju prethodno obavestiti za takav sastanak.
- 6.3. U slučajevima kada se lokalni savet razreši u skladu sa procedurama iz stava 2, novo glasanje se mora odmah izvršiti, u skladu sa postupcima iz člana 5 ove uredbe, kako bi se izabrao novi lokalni savet. Rezultate glasanja treba prijaviti na osnovu zahteva iz člana 6 ove uredbe.
- 6.4. Mandat predsednika i članova lokalnih veća završava se:
- 6.4.1. sa završetkom mandata,
 - 6.4.2. ako umre,
 - 6.4.3. ako da otkaz,
 - 6.4.4. ako promenite prebivalište,
 - 6.4.5. ako se otpusti,
 - 6.4.6. ako izvrši krivično delo.

Član 7

Zapisnik sa izbornog mitinga

- 7.1. Zapisnik sastanka građana treba da sadrži: datum, vreme i mesto sastanka, broj građana koji prisustvuju skupu, listu učesnika, podatke o izboru članova i predsednika lokalnih veća, glasanje i druga pitanja upućena na sastanku.
- 7.2. Zapisnik potpisuju predsednik sastanka, članovi komisije i zapisničar, a komisija utvrđena u skladu sa članom 4. ove uredbe izvestava Skupštini opštine o toku mitinga i izbora lokalnih veća sela, naselja ili urbanih kvartova.
- 7.3. Rezultati izbora, imena članova i predsedavajućeg lokalnog veća, trebaju se objaviti odmah nakon izbornog mitinga.

Član 8

Konsultacije između opštine i lokalnih veća

- 8.1. Predsedavajući Skupštine i predsednik pozivaju predstavnike sela, naselja i urbanog naselja da prisustvuju na javnim skupovima sa građanima, na javnim raspravama o budžetu, redovnim javnim

skupovima, sastancima o planiranju opštinskih politika razvoja koje organizuju opštinski organi.

- 8.2. Najmanje jedan član lokalnog veća sela, naselja ili urbanog naselja treba da bude uključen u sve opštinske radne grupe za planiranje urbanističkih, razvojnih i ruralnih planova koji su deo lokaliteta u kojem žive.
- 8.3. Predsednik treba organizovati najmanje dva sastanka godišnje sa lokalnim odborima. Sastanci se moraju održavati najmanje jednom u šest meseci. Za dnevni radu trebaju se konsultovati i predsednici lokalnih veća.
- 8.4. Skupština opštine može zatražiti mišljenje lokalnog veća sela, naselja ili urbanog naselja o određenim pitanjima od interesa za zajednicu.

Član 9

Prenošenje aktivnosti od opštine na lokalna veća

- 9.1. Na osnovu zahteva lokalnog veća i preporuke Predsednika opštine, ili nekog od Komiteta opštine, Skupština opštine uz odluku može nositi neke odgovornosti za vršenje lokalnih veća sela, naselja i urbanih kvartova. Aktivnosti koje se mogu preneti treba biti u isključivoj nadležnosti opštine.
- 9.2. Lokalno veće sela, naselja i urbanog naselja, treba se konsultirati i prihvatiti transfer aktivnosti od opštine na lokalnom veću.
- 9.3. U slučaju prenosa aktivnosti od opštine na lokalnom veću, opština će se obavezati da obezbedi dovoljnu podršku i resurse lokalnim kancelarijama / seoskim većima, naseljima i urbanim naseljima kako bi ispunila odgovornosti koje su joj se prenele.

Član 10

Uloga, dužnosti i odgovornosti lokalnih veća

- 10.1. Lokalno veće sela, naselja ili gradskog naselja može se sastati u bilo koje vreme kako bi razmatra pitanja u interesu lokaliteta, te da izrađuje i usvaja plan rada veća i unutrašnja pravila poslovanja.
- 10.2. Lokalni savet sela, naselja ili urbanog naselja organizuje, prati i planira lokalne planove i programe razvoja u svim oblastima, u saradnji sa Skupštinom opštine, Predsednikom Opštine, komitetima i opštinskim direkcijama.
- 10.3. Lokalno veće sela, naselja ili urbanog naselja treba obavestiti opštinu o vremenu i dnevnom redu sastanaka. Opštinski službenici mogu učestvovati na sastancima koje organizuju lokalni saveti.

- 10.4. Lokalni saveti mogu formirati lokalne pod-savete, na osnovu zoniranja i broja lokalnih područja navedenih na listi aneksa, koja je deo ove uredbe.
- 10.5. Sastanci sa građanima mogu biti organizovani na inicijativu lokalnog veća sela, naselja ili urbanih kvartova.
- 10.6. Lokalni savet može preduzimati aktivnosti koje na specifičan način utiču na:
 - 10.6.1. održivi lokalni ekonomski razvoj lokaliteta;
 - 10.6.2. urbano i ruralno planiranje lokaliteta;
 - 10.6.3. zaštita lokalnog okruženja lokaliteta;
 - 10.6.4. povećanje efikasnosti u pružanju opštinskih javnih usluga unutar lokaliteta;
 - 10.6.5. pružiti osnovne podatke za svaku porodicu odgovarajućeg lokaliteta, prati njihovo ekonomsko, socijalno stanje, i daje preporuke, predloge za podršku ovih slučajeva;
 - 10.6.6. održavanje groblja i javnih zelenih površina;
 - 10.6.7. razvoj turizma;
 - 10.6.8. organizacija kulturnih i sportskih aktivnosti;
 - 10.6.9. saradnju sa opštinskim organima i drugim organizacijama civilnog društva o pitanjima od interesa za lokalitet;
 - 10.6.10. organizovanje dobrovoljnih akcija u interesu lokaliteta;
 - 10.6.11. sprovođenje aktivnosti koje su prebačene, u skladu sa procedurama iz člana 8. ove uredbe.
- 10.7. Odlukom Predsednika, član lokalnog veća može biti deo nadzornih tela za praćenje, sprovođenje kapitalnih investicionih projekata u njihovim lokalitetima.
- 10.8. Lokalni saveti sela, naselja i urbana naselja imaju pravo da saraduju na teritoriji određene opštine.
- 10.9. Lokalni saveti imaju pravo da podnesu pismeni zahtev opštinskim vlastima za razna pitanja u interesu lokaliteta, dok opštinska tela u roku od 30 dana pismeno odgovaraju lokalnom savetu.

Član 11

Uloga predsednika lokalnih veća

- 11.1. Predsednik opštinskog veća predstavlja selo, naselje ili urbano naselje u konsultacijama i diskusijama sa organima opštine. Predsednik lokalnog veća dužan je da obavesti članove Saveta o rezultatima ili zaključcima sa sastanaka opisanih u prethodnom stavu.
- 11.2. Predsednik lokalnog veća poziva i predsedava sastancima lokalnog veća i vodi računa o organizaciji i radu lokalnog veća. On takođe potpisuje zaključke i predloge koje je usvojio lokalni savet i dužan je da ih preda predsedniku opštine u roku od 15 dana od dana njihovog usvajanja.

Član 12 **Finansiranje aktivnosti**

- 12.1. Finansiranje aktivnosti lokalnih veća mogu vršiti stanovnici sela, naselja ili urbanog naselja, od strane opštine, zajedničkim finansiranjem, i donatorima, u potpunoj saglasnosti sa Statutom, opštinskim propisima i zakonodavstvom koji se primenjuju u Republici Kosova za upravljanje javnim finansijama.
- 12.2. Lokalno veće priprema polugodišnje i godišnje izveštaje o prikupljenim sredstvima i potrošenim sredstvima i čini ih transparentnim za građane tog lokaliteta i opštinska tela.
- 12.3. Lokalni saveti su obavezni da svoje finansijske poslove obavljaju preko bankovnog računa u ime lokalnog veća.

Član 13 **Nadoknada lokalnih veća**

Nadoknađivanje predsednika lokalnih veća sela, naselja i urbanih kvartova određuje Skupština opštine posebnom odlukom.

Član 14 **Neizvršenje odgovornosti**

Lokalno veće sela, naselje i odgovarajućeg urbanog naselja nosi zakonske obaveze i odgovornosti za sve aktivnosti koje sprovodi Skupština opština u lokalnom veću.

Član 15 **Prelazne, ukinute i konačne odredbe**

15.1. U slučaju sukoba odredaba ove uredbe sa Zakonom o lokalnoj samoupravi i Statutom opštine, prevladavaju odredbe Zakona i Statuta.

15.2. Po stupanju na snagu ovog pravilnika, ukida se Pravilnik o organizaciji i saradnji opštine sa selima, naseljima i urbanim kvartovima teritorije opštine Priština, 01 br. 110-1201, dt. 16.06.2010 god..

Član 16 **Izmene**

Svaka izmena i dopuna ovog pravilnika vrši se po istom postupku usvajanja ovog pravilnika.

Član 17
Stupanje na snagu

Ovaj pravilnik stupa na snagu 15 (petnaest) dana nakon registracije u Kancelariji Protokola Ministarstva za Administraciju Lokalne Samouprave, kao i objavljivanje na službenom jeziku na veb stranici Opštine.

SKUPŠTINA OPŠTINA PRIŠTINA
01-030/01-0134831/18, dana 06.06.2018



PREDSEDAVAJUĆI SKUPŠTINE OPŠTINE
Agim Kuleta